

Emertimi dhe Forma ligjore:
NIPT –i:
Adresa e Selise:
Data e krijimit:
Veprimtaria Kryesore:

“TRIANGLE MEDIA PRODUCTION” sh.p.k
L11913017I
TIRANE
23/11/2009
STUDIO AUDIO VIDEO

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2019

Pasqyrat Financiare jane individuale
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek
Pasqyrat Financiare nuk jane te rumbullakosura
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2019-31.12.2019
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 31.05.2020



Pasqyra e Pozicionit Financiar	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	46,193,997	39,029,112
Investime		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
Te drejta te arketueshme		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	2,521,345	6,721,988
<i>Te tjera</i>	0	0
Inventaret		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	0	0
<i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i>	0	0
<i>Produkte te gatshme</i>	0	0
<i>Mallra</i>	0	0
Shpenzime te shtyra	0	0
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara	0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra	48,715,342	45,751,100
Aktive afatgjate		
Aktive financiare		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
Aktive materiale		
<i>Toka dhe ndertesa</i>		
<i>Impiante dhe makineri</i>		
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	1,719,508	2,040,739
Aktivitet biologjike		
Aktive jo materiale		
<i>Emri i mire</i>		
Aktivitet tatimore te shtyra		
Totali i aktiveve afatgjate	1,719,508	2,040,739
TOTALI I AKTIVEVE	50,434,850	47,791,839

Administratori

Genç Gjineci



Pasqyra e Pozicionit Financiar DETYRIMET DHE KAPITALI	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
Detyrime afatshkurtra		
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	4,536,469	3,593,166
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	3,946,610	2,767,447
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	1,463,594	2,545,401
<i>Te tjera te pagueshme</i>	0	0
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
Te ardhura te shtyra		
Provizione		
Totali i detyrimeve afatshkurtra	<u>9,946,673</u>	<u>8,906,014</u>
Detyrime afatgjata		
<i>Titujt e huamarrjes</i>		
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
Te ardhura te shtyra		
Provizione		
<i>Provizione per pensione</i>		
Detyrime tatimore te shtyra		
Totali i detyrimeve afatgjata	<u>0</u>	<u>0</u>
Detyrime totale	<u>9,946,673</u>	<u>8,906,014</u>
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nenshkruar	17,630,000	17,630,000
Primi i lidhur me kapitalin	0	0
Rezerva rivleresimi	0	0
Rezerva te tjera	0	0
<i>Rezerva ligjore</i>	5,479	5,479
<i>Rezerva te tjera</i>	21,250,346	15,551,497
Fitimi/(humbja) e pashperndare	0	0
Fitimi/(humbja) e periudhes	1,602,352	5,698,849
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	<u>40,488,177</u>	<u>38,885,825</u>
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	<u>40,488,177</u>	<u>38,885,825</u>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	<u>50,434,850</u>	<u>47,791,839</u>

Administratori

Genc Gjineci



Pasqyra e Performances (<i>sipas natyres</i>)	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	16,795,392	43,349,044
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	0	0
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces	0	0
Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar	0	0
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	0	0
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	0	0
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	0	0
<i>Te tjera shpenzime</i>	0	0
Shpenzime te personelit	0	0
<i>Paga dhe shperblime</i>	-3,694,471	-3,270,465
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	-592,896	-399,926
<i>Shpenzimet per pensionet</i>	0	0
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale	0	0
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-529,494	-651,772
Shpenzime te tjera shfrytezimi	-9,176,845	-29,133,382
Te ardhura te tjera	0	0
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*</i>	0	0
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra	0	0
Shpenzime financiare	0	0
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	-502,290	-2,884,285
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	-352,135	-258,983
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet	0	0
Te tjera (<i>pershkruaj</i>)	0	0
Fitimi/(humbja) para tatimit	1,947,261	6,750,231
Tatimi mbi fitimin		
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	-344,909	-1,051,382
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	1,602,352	5,698,849
Te ardhura te tjera gjithepershires per periudhen/vitin:		
<i>Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>		
Totali i te ardhurave te tjera gjithepershires per periudhen/vitin (B)	0	0
Totali i te ardhurave gjithepershires per periudhen/vitin (A+B)	1,602,352	5,698,849

Administratori

Gene Gjineci



Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	1,947,261	6,750,231
Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare:		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	529,494	651,772
<i>Shpenzime te shtyra</i>	0	0
Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	0
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	4,200,643	232,906
Rënie/(rritje) në inventarë	0	0
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	791,635	3,448,160
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	0	0
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	7,469,033	11,083,069
Tatim fitimi i paguar gjate periudhes	-95,885	0
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	-208,263	-31,750
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	0
<i>Dividentë të arkëtuara</i>	0	0
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	-208,263	-31,750
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
<i>Dividendë të paguar</i>	0	0
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	0	0
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	7,164,885	11,051,319
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	39,029,112	27,977,793
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	46,193,997	39,029,112

Administratori

Genc Gjineci



Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto	Kapitali i nenshkruar	Rezerva te tjera	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali
Pozicioni financiar ne fillim	5,500,000	25,690,718	1,996,258	33,186,976
Efekt i ndryshimeve ne politikat kontabile				0
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim	5,500,000	25,690,718	1,996,258	33,186,976
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:				0
Fitim/(humbja) e periudhes			5,698,849	5,698,849
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse				0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	0	5,698,849	5,698,849
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:				0
Emetim i kapitalit të nënshkruar				0
Dividende te shperndare				0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)		1,996,258	-1,996,258	0
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	0	1,996,258	-1,996,258	0
Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)	5,500,000	27,686,976	5,698,849	38,885,825
				0
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:				0
Fitim/(humbja) e periudhes			1,602,352	1,602,352
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse				0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	0	1,602,352	1,602,352
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:				0
Emetim i kapitalit të nënshkruar				0
Dividende te shperndare				0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)		5,698,849	-5,698,849	0
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	0	5,698,849	-5,698,849	0
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)	5,500,000	33,385,825	1,602,352	40,488,177

Administratori

Genc Gjineci



SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria është regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Rregjistrimit në datë 13.07.2011. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 17,630,000 leke dhe zotërohet dhe administrohet nga ortakët i vetëm Z. Genc Gjineci. Objekti i veprimtarisë është prodhim reklama Audio Vizuale, radio.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "*Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "*Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre*", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.



2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi

flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe

detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci kontabel, aktivitet

4. Aktive monetare

Gjendja e aktiveve monetare ne date 31.12.2019 eshte ne shumen 46,193,997 leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Aktive monetare	46,193,997	39,029,112
	Totali	<u>46,193,997</u>	<u>39,029,112</u>

Diferencat e konvertimit jane kompesuar te te ardhurat dhe shpenzimet dhe jane marre ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Te drejta te arketueshme

Ne kete post paraqiten te drejta te arketueshme me 31.12.2019 ne shumen 2,521,345 leke, si me poshte:

Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2019	Viti 2018
1	Nga aktiviteti I shfrytezimit	2,521,345	6,721,988
	Totali	<u>2,521,345</u>	<u>6,721,988</u>

6. Aktive afat gjata materiale

Gjendja e aktiveve eshte paraqitur me vleren kontabel te mbetur, ne shumen 1,719,508 leke si me poshte:

Nr	Aktivitet materiale	Viti 2019	Viti 2018
1	Pajisje zyre dhe informatike	1,719,508	2,040,739
	Shuma	<u>1,719,508</u>	<u>2,040,739</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019.

Bilanci kontabel, pasivet

7. Detyrimet Afatshkurtra

Ne kete post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra me 31.12.2019 ne shumen 9,946,674 leke.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2019	Viti 2018
1	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	4,536,469	3,593,166
2	Të pagueshme ndaj punonjësve /sig	3,946,610	2,767,447
3	Të pagueshme për detyrimet tatimore	1,463,594	2,545,401
	Totali I detyrimeve	<u>9,946,674</u>	<u>8,906,014</u>

7.1 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Paraqitet gjendja furnitoreve e palikujduar ne shumen 4,536,469 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2019 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

7.2 Te pagueshme ndaj punonjesve e sigurimeve shoqerore

Ne kete ze eshte perfshire gjendja e pagave te palikujduara me 31.12.2019 ne shumen 3,946,610leke.

7.3 Detyrime tatimore

Jane pasqyruar detyrimet e shoqerise ndaj shtetit me 31.12.2019, ne shumen 1,463,594 leke, si me poshte:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2019	Viti 2018
1	Tatimi mbi te ardhurat personale	69,641	37,739
2	Tatim mbi vleren e shtuar	70,455	1,473,982
3	Tatim fitimi	1,274,757	1,025,730
4	Tatim ne burim	48,741	7,950
	Totali I detyrimeve	<u>1,463,594</u>	<u>2,616,509</u>



8. Kapitali

Shoqeria ka kapital te regjistruar ne shumen 17,630,000 leke. Kapitalet e veta jane shtuar me fitimin e vitit ushtrimor 2019 ne shumen 1,602,352 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise me 31.12.2019 eshte 40,488,177 leke. Levizja e grupit te kapitaleve te veta per vitin 2019 paraqitet si me poshte:

Nr	Emertimi	Kapitali i nenshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2018	17,630,000	5,479	15,551,497	5,698,849	38,885,825
2	Shtesat per 2019	-	-	5,698,849	1,602,352	7,301,201
3	Paksimet per 2019	-	-	-	(5,698,849)	(5,698,849)
	Gjendja me 31.12.2019	<u>17,630,000</u>	<u>5,479</u>	<u>21,250,346</u>	<u>1,602,352</u>	<u>40,488,177</u>

Pasqyra e Te Ardhurave Dhe Shpenzimeve

9. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Ne kete post jane rregjistruar shitjet per sherbimet e ofruara te cilat jane realizuar per vitin 2019 ne shumen 16,795,392 leke.

Nr	Pershkrimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Te ardhura nga shitja e sherbimeve	16,795,392	43,349,044
	Shuma	<u>16,795,392</u>	<u>43,349,044</u>

10. Kostot e punes

Shpenzimet per personelin per vitin 2019 paraqiten ne shumen 4,287,367 leke si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2019	Viti 2018
1	Shpenzime per paga	3,694,471	3,270,465
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	592,896	399,926
	Shuma	<u>4,287,367</u>	<u>3,670,391</u>

11. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Amortizimi vjetor i aktiveve afat gjata materiale eshte llogaritur ne shumen 529,494 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Amortizimi I aseteve	529,494	651,772
	Shuma	<u>529,494</u>	<u>651,772</u>

12. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Jane perfshire shpenzime te cilat i perkasin vitit 2019, ne shumen 9,176,845 leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Sherbim Transmetimi	5,778,139	19,026,859
3	Qira	636,000	636,000
5	Shpenzim telefonik, interneti	660,047	692,370
7	sherbime bankare	22,644	29,821
9	Taksa vendore	47,000	47,000
11	Dieta per personelin	1,535,000	6,236,000



13	Tarife rinovimi AMA	350,000	348,000
15	Te tjera	148,016	451,974
17	Bileta udhetimi	-	1,665,357
	Shuma	<u>9,176,845</u>	<u>29,133,382</u>

13. Shpenzime financiare

Jane paraqitur te shpenzime financiare ne shumen 854,425 leke per vitin 2019, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Gjoha e penalitete	352,135	258,985
2	Fitime/Humbje nga kursi I kembimit	502,290	2,884,285
	Shuma	<u>854,425</u>	<u>3,143,269</u>

14. Llogaritja e tatimit te fitimit

Shoqeria per vitin 2019 paraqitet me fitim ne shumen 1,602,351 leke, shpenzime te pazbritshme 352,135 leke.

Nr	EMERTIMI	VITI 2019	VITI 2018
1	Te ardhura	16,795,392	43,349,044
2	Shpenzime	(14,848,131)	(36,598,813)
3	Rezultati	<u>1,947,261</u>	<u>6,750,231</u>
4	Shpenzime te pazbritshme	<u>352,135</u>	<u>258,985</u>
	b) Gjoha e penalitete	352,135	258,985
5	Rezultati tatimor	<u>2,299,396</u>	<u>7,009,216</u>
6	Tatim fitimi	344,909	1,051,382
7	Fitimi neto	<u>1,602,352</u>	<u>5,698,849</u>

15. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2019 Shoqeria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

16. Ngjarje pas datës së Bilancit

Ngjarje pas dates se bilancit eshte situata e krijuar gjate periudhes se fatkeqesise natyrore, e shpallur si pasoje e COVID-19.

Administratori

Genç Gjineci

